# DËSHMI ARKIVI

**A-465077**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Ujësjellësit, BB: Ngecin planet e biznesit, vonesa edhe te raportimi për mashtrim dhe korrupsion |
| ADRESA | `https://lapsi.al/ujesjellesit-bb-ngecin-planet-e-biznesit-vonesa-edhe-te-raportimi-per-mashtrim-dhe-korrupsion-i1094366` |
| BURIMI | lapsi.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 24 shtator 2026, 08:44:59 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 24 shtator 2026, 08:43:13 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `aed192b16bf3829b60e0ca73b5f906dd88a0359e0362042557fa94cedaea160e` |
| TEKSTI | `1a9d196d21891cba70a65aec2664d9d876ed8536f029520f7a1399bc6c83c10b` |
| PAMJA | `885ca36008dcf7bf6d45b7e04cf3f9f98f181042cf29fe81be8df0173c2e49cf` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `a72c53b823a5ccd6dfc575f7c05d973f9d067f2b607844cbc5c76ee1fc32c6c8` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `9a6b20a4f7bca7d38b85ed38d229f05609a1ca606edde02ba3c9e62d673a221c` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/a72c53b823a5ccd6dfc575f7c05d973f9d067f2b607844cbc5c76ee1fc32c6c8`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Ujësjellësit, BB: Ngecin planet e biznesit, vonesa edhe te raportimi për mashtrim dhe korrupsion

LAPSI.AL • 24 SEPTEMBER 2026



Banka Botërore e vlerëson si “mesatarisht të kënaqshëm” zbatimin e programit për modernizimin e sektorit të ujësjellës-kanalizimeve në Shqipëri, por raporti i saj i fundit evidenton vonesa në planet e biznesit të ndërmarrjeve, mekanizmat e investimeve dhe raportimin për pretendimet për mashtrim dhe korrupsion.

Raporti e mban në 0% treguesin e ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve që kanë dorëzuar plane biznesi në ERRU për miratim, kundrejt një objektivi fillestar prej 60%.Matja e shënuar në tabelë për këtë tregues është e shtatorit 2022. Banka sqaron se metodologjia u miratua nga ERRU në nëntor 2025 dhe se, pas rishikimit afatmesëm, objektivi përfundimtar do të ulet në 40% “për të marrë parasysh vonesat në miratimin e saj”.

Në 0% figuron edhe treguesi për përqindjen e ndërmarrjeve që marrin alokime investimesh bazuar në kriteret e pranueshmërisë dhe performancës. Raporti thotë se përshkrimi dhe objektivi përfundimtar i këtij treguesi do të rishikohen dhe se, pas agregimit, të paktën një ndërmarrje rajonale e ujësjellësit duhet ta përmbushë objektivin. Një tjetër vonesë lidhet me mekanizmin për mbledhjen e informacionit mbi “pretendimet e besueshme dhe materiale për mashtrim dhe korrupsion” në kuadër të programit, masat e marra ose në proces dhe raportimin e tyre te Banka Botërore. Përgjegjësia i është caktuar Ministrisë së Drejtësisë dhe raportimi është parashikuar çdo vit. Në dokument, Banka shkruan se “aktiviteti në tërësi është i vonuar, në pritje të miratimit të Ministrisë së Drejtësisë”. Raporti nuk identifikon në këtë pjesë raste konkrete korrupsioni dhe konstatimi i tij është për vonesën e mekanizmit të raportimit.

Treguesit e furnizimit me ujë paraqesin gjithashtu boshllëqe ndaj objektivave. Numri i zonave urbane me të paktën 18 orë furnizim me ujë mbetet 15, sipas matjes së shënuar për shtatorin 2022, kundrejt objektivit prej 35 deri në dhjetor 2027. Ndërkohë, 29% e ndërmarrjeve rezultonin në dhjetor 2025 se përmbushnin të paktën 75% të objektivave të marrëveshjeve të performancës, kundrejt objektivit fillestar prej 90%. Pas rishikimit

ide


Rënia e Vlorës në shtratin e krimit
Armand Shkullaku


Haga, si përfundim i një epoke të gjatë yes man-izmi
Andi Bushati

MOTI TIRANA 22°C
KËMBIMI EURO 91.46

aktuale

07:44
Ditë e ngarkuar në Kuvend: Protestë jashtë, interpelanca dhe debate brenda

20:33

Protestuesit kërkojnë "kokën" e Ramës: Krejt ekipi në pranga, s'të shpëton dot as banda



TIA dhe Vodafone sjellin teknologjinë Airbus në Tiranë

Ndiqe Lapsin edhe në

Me interes nga publiku



afatmesëm është rënë dakord që indikatori të ndryshojë, duke kërkuar përmbushjen e të paktën 50% të objektivave, ndërsa objektivi përfundimtar do të jetë 50% e ndërmarrjeve.

Për familjet vulnerabël, raporti shënon 104 lidhje të reja funksionale që ofrojnë shërbim të sigurt dhe të besueshëm me ujë, me matje të shtatorit 2022, kundrejt objektivit prej 3,000 deri në dhjetor 2027. Në treguesin më të gjerë, 5,342 persona rezultojnë se kanë përfituar akses në burime të përmirësuara uji, me të dhënat e fundit të korrikut 2025, kundrejt objektivit 40,000. Në zonat rurale shifra është 5,342 kundrejt objektivit 32,000, ndërsa për zonat urbane raporti shënon zero, kundrejt objektivit 8,000.

Raporti evidenton ecuri më të mirë në performancën financiare. Treguesi kombëtar për mbulimin e kostove direkte operative arriti 109.6 në mars 2026. Banka e lidh përmirësimin me rritjen e të ardhurave nga shitjet dhe tarifat, përmirësimin e faturimit, administrimit të klientëve dhe arkëtimeve.

Dokumenti vëren gjithashtu se baza e këtij treguesi duhet të rishikohet në 94.6, pas verifikimit të vitit 2022, me objektiv përfundimtar 104.6. Disa ndërmarrje kanë përmirësuar gjithashtu kontrollin e kostove të energjisë, personelit dhe mirëmbajtjes.Janë kryer edhe 12 auditime të eficiencës energjetike në pesë ndërmarrje rajonale, që mbulojnë 23 bashki; raporti e konsideron këtë objektiv të arritur dhe të tejkaluar. Sistemi i ri i monitorimit dhe krahasimit të performancës është gjithashtu ngritur dhe funksionon.

Programi Kombëtar për Modernizimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në Shqipëri u miratua në maj 2022 dhe synon të përmirësojë performancën operative dhe financiare të ndërmarrjeve dhe të zgjerojë aksesin në shërbime të furnizimit me ujë të menaxhuara në mënyrë të sigurt.

Në miratim, Banka Botërore e strukturoi financimin me një hua prej 75 milionë dollarësh dhe një grant prej 6.3 milionë dollarësh. Huaja është pjesë e një programi prej 135 milionë dollarësh të bashkëfinancuar nga qeveria shqiptare. Në raportin aktual, vlera e huasë figuron e rishikuar në 78.27, me 35.88 të disbursuara, ose 45.84%, ndërsa nga granti janë disbursuar 2.19, ose 34.76%. Projekti pritet të mbyllet në fund të vitit 2027./ Monitor


## Të këshilluara



**Grupi parlamentar i PD hyn në Kuvend së bashku me Berishën**

Grupi parlamentar i Partisë Demokratike ka hyrë në Kuvend së bashku me kreun e partisë, Sali Berisha, aty ku pritet të nisë ...



**Seanca plenare, PD kërkon ndryshimin e rendit të ditës: Rama të japë shpjegime për situatën e rëndë në SHISH**

Grupi parlamentar i PD ka kërkuar ndryshimin e rendit të ditës së seancës plenare të Kuvendit të 24 shtatorit, dhe të j...





1 **Përgjimet ekskluzive/ "O shpirt", "o zemër". Vlora, një spiune që pasioni e çoi drejt krimit**



2 Bomba tjetër për qeverinë Rama/ Prova e fakte se ku shkojnë paratë e zhvatura nga korrupsioni



3 Mesazhet me shefen e SHISH/ Gys Agasi i mbajti shpresat te Edi Rama deri në fund



4 Zbulohet kush e zëvendëson Vlora Hysenin në krye të SHISH



## Nis protesta, shoqërohen dy persona pranë Ministrisë së Brendshme




### Dosja e SPAK, Agasi mori të dhëna në telefonat e "zbërthyer" nga policia

Detaje të reja dalin nga dosja hetimore e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) lidhur me ...



### Vlora Hyseni i jepte garanci Ergys Agasit: Krejt radarët e shtetit i fik për ty

Detaje të reja kanë dalë në dritë nga komunikimet mes Vlora Hysenit dhe Ergys Agasit, me këtë të fundit që shfryt&...



### Jashtë protestë, brenda seancë plenare, policia ngre gardhet metalike përreth Kuvendit

Policia ka rrethuar zënën pranë Kuvendit me gardh metalik, pasi qytetarët kanë njoftuar protestë në të njejtën koh...




## Dalin sot para GJKKO ish-drejtoresha e SHISH dhe Fatjon Kalluci e Embro Sulejmani



### BIRN: "Garancia e plotë" e Ramës dhe përgjegjësia e tij politike për Vlora Hysenin

Nga Nju Jorku, ku ndodhej për Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së, kryeministri Edi Rama reagoi ndaj masës së arrestit sht&eu...



### Trump u ndaloi disa mediave raportimin në Shtëpinë e Bardhë, Gjykatësi urdhëron rikthimin e aksesit



Një gjykatës federal në SHBA ka urdhëruar Shtëpinë e Bardhë të rikthejë aksesin e gazetarëve të CNN, MS ...



**Evropa shqyrton plane emergjente pas provokimeve ruse dhe paralajmërimeve për sulm të mundshëm**

## Me sytë katër



22:43

### PAMJET VIRALE/ Presidenti i Haitit pi ujë me kanë në mes të OKB-së

Presidenti i Haitit, Edgar Leblanc Fils është bërë një "yll i memeve" në orët e fundit pas një gabimi epik g...



PAMJET/ Rrëzohet gjatë stërvitjes në Uells avioni ushtarak britanik

21:28



"E ke dëgjuar atë këngën Zegjine, Zegjine..."/ Aktivistja i zë pritë deputetes së PS

21:17



PAMJET/ 6-vjeçarja kineze vë rekord botëror për zgjidhjen e Kubit të Rubikut

21:27



PAMJET/ Nis papritur bora në bjeshkët e Deçanit

20:52

## SPORT

Të tjerë artikuj



22:14

Portieri kthen shpinën gjatë penalltisë absurde: kishte marrëveshje me sulmuesin, por tradhtohet



21:49

Aksidenti absurd, 20-vjeçari Oskar Kordus humb jetën: një kaproll i futet përmes xhamit të përparmë të makinës



21:11

Klopp i ndalon lojtarëve të Gjermanisë parukierin: rregulla strikte për kombëtaren e tij



21:07

Përplasje verbale mes Van Dijk dhe një gazetari në sallën e konferencës:



15:27

"Jam futbollisti më i bukur në botë": moda,



15:21

Sulmi kuqezi kundër teknikut Sylvinho, Daku e Seferi kunja brazilianit:



12:43

Kush është Younes Ebnoutalib, i thirrur nga Klopp te Gjermania me një përvojë te Perugia në




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.